



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

*Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit – Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta –
Ministry of Culture, Youth and Sport*

RREGULLORE (MKRS) NR. 01/2024 PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, PROCEDURAVE DHE FORMËS PËR VËRTETIMIN E SPONSORIZIMIT NË FUSHËN E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT¹

¹ Rregullore (MKRS) Nr. 01/2024 për Përcaktimin e Kriteve, Procedurave dhe Formës për Vërtetimin e Sponsorizimit në Fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit miratuar nga Ministri me Vendimin Nr. 58/2024, të datës 28.05.2024

Ministri i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit,

Në mbështetje të nenit 4 (paragrafi 5) të Ligjit Nr. 05/L-090 për Sponsorizime në Fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (Gazeta Zyrtare, Nr. 3/2017, 17.01.2017), nenit 11, paragrafi 1.5, të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe nenit 38, paragrafi 6, të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011 (Gazeta Zyrtare Nr. 15, 12.09.2011),

Nxjerr:

RREGULLORE NR. 01/2024 PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, PROCEDURAVE DHE FORMËS PËR VËRTETIMIN E SPONSORIZIMIT NË FUSHËN E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kriterëve, procedurave dhe formës së vërtetimit të sponsorizimit në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, si fusha të interesit publik, sipas përkufizimit të dhënë në Ligjin 05/L-090 për Sponsorizime në Fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit si dhe në përputhje me fushat e përgjegjësisë së Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Neni 2 Fushëveprimi

Me anë të kësaj rregulloreje përcaktohen kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta për sponsorizime në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, procedurat e lëshimit të vërtetimit për sponsorizim, formati i vërtetimit për sponsorizim dhe procedura e raportimit vjetor për sponsorizimin e realizuar.

Neni 3 Kriteret e përgjithshme

1. Bazuar në legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës dhënësit e sponsorizimit në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit aktivitetin e tyre duhet ta kenë të regjistruar, licencuar dhe fiskalizuar nëpër institucionet dhe organizatat kompetente sipas mandatit të tyre.
2. Përfituesit e sponsorizimit në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit duhet të jenë të regjistruar nëpër organizatat, institucionet përkatëse për kulturë, rini dhe sport, qoftë në nivel lokal apo qendror.

3. Sponsorizuesit në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit mund të jenë persona fizikë dhe juridikë, vendës ose të huaj.
4. Përfitues të sponsorizimit mund të jenë personat fizikë – shtetas të Republikës së Kosovës dhe personat juridikë të regjistruar në Republikën e Kosovës, të cilët zhvillojnë aktivitete në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit.
5. Aktiviteti i sponsorizuar duhet të jetë qartësisht i përcaktuar si interes publik në përputhje me politikat shtetërore në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit në Republikën e Kosovës.
6. Përfituesit individual të sponsorizimit mjetet e përfituara nga sponsorizimi duhet t'i transferohen përmes:
 - 6.1. Në fushën e sportit vetëm përmes klubit të licencuar në Ministrinë përgjegjëse për Sport;
 - 6.2. Në fushën e kulturës përmes organizatës/shoqatës;
 - 6.3. Në fushën e rinisë përmes organizatës/shoqatës.
7. Sponsorizimi është i vlefshëm vetëm atëherë kur pala e pranon vërtetimin nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe transferimi i mjeteve duhet të bëhet pas pranimit të vërtetimit.

Neni 4 **Kriteret e veçanta në fushën e kulturës**

1. Përfituese të sponsorizimit në fushën e kulturës mund të jenë të gjitha institucionet kulturore publike në nivel lokal dhe qendror.
2. Përveç institucioneve lokale dhe qendrore, përfitues të sponsorizimit në fushën e kulturës mund të jenë:
 - 2.1. Organizatat/shoqatat të cilat fushëveprimin e kanë në fushën e kulturës;
 - 2.2. Artistët e pavarur që zhvillojnë aktivitetin e tyre në kuadër të organizatave/shoqatave;
 - 2.3. Bizneset (që veprimtari primare kanë prodhimin e filmit).
3. Përfituesit që kanë të drejtë të përfitojnë nga ligji për sponsorizim në fushën e kulturës janë ato që zhvillojnë aktivitete kulturore në fushën e teatrit, arteve vizuale, librit dhe bibliotekarisë, arteve performative, në fushën e muzikës dhe filmit.
4. Të gjithë përfituesit duhet të kenë veprimtari të dëshmuar në 2 vjetët e fundit në fushën për të cilën kanë aplikuar.

5. Të gjithë përfituesit e sponsorimit, sipas paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni, duhet të jenë të regjistruar në institucionet përkatëse të Kosovës, sipas ligjeve në fuqi që rregullojnë përkrahjen dhe mbështetjen e aktiviteteve kulturore në Republikën e Kosovës.

Neni 5 **Kriteret e veçanta në fushën e rinisë**

1. Përfitues të sponsorizimit në fushën e rinisë mund të jenë:

- 1.1. Organizatat rinore dhe organizatat për të rinjtë që veprimtari primare kanë fushën e rinisë;
- 1.2. Individët që janë të moshës rinore dhe që zhvillojnë aktivitetin e tyre në kuadër të organizatave rinore apo organizatave për të rinjtë;
- 1.3. Qendrat rinore të cilat janë të licencuara nga institucionet përkatëse.

2. Përfituesit që kanë të drejtë të përfitojnë nga ligji për sponsorizim në fushën rinisë janë ata që zhvillojnë aktivitete me interes për moshën rinore, si fuqizimin apo pajisjen e të rinjve me shkathtësi për një jetë të suksesshme e të begatë, përmirësimin e cilësisë së shërbimeve dhe mbështetjes së ofruar për të rinjtë, përmirësimin e politikave rinore dhe fuqizimin e të rinjve në vendimmarrje, politikëbërje dhe zbatim të programeve që synojnë zhvillimin e shoqërisë.

3. Të gjithë përfituesit duhet të kenë veprimtari të dëshmuar në 2 vjetët e fundit në fushën për të cilën kanë aplikuar.

4. Të gjithë përfituesit e sponsorimit sipas paragrafit 1 të këtij neni duhet të jenë të regjistruar në institucionet përkatëse të Kosovës, sipas ligjeve në fuqi që rregullojnë fushëveprimin e rinisë në Republikën e Kosovës.

Neni 6 **Kriteret e veçanta në fushën e sportit**

1. Përfitues të sponsorizimit në fushën e sportit mund të jenë të gjitha organizatat sportive të njohura nga ligji përkatës për sport duke përfshirë:

- 1.1. Organizatat ombrellë të sportit;
- 1.2. Federatat sportive shtetërore të licencuara nga Ministria përkatëse për Sport;
- 1.3. Klubet sportive të licencuara nga Ministria përkatëse për Sport;
- 1.4. Të gjithë personat e tjerë juridikë të njohur me ligjin përkatës për sport, të cilët plotësojnë kriteret për zhvillimin e veprimtarisë së tyre në përputhje me ligjet në fuqi.

2. Përveç personave juridikë, përfitues të sponsorizimit në fushën e sportit mund të jenë edhe personat fizikë (individët):

2.1. Sportistët të cilët janë pjesë e përfaqësueseve të Kosovës;

2.2. Sportistët të cilët janë anëtarë të klubeve sportive të licencuara nga Ministria përkatëse për Sport dhe anëtare të federatave sportive përkatëse.

3. Të gjithë përfituesit (personat juridikë apo fizikë) duhet të kenë veprimtari të dëshmuar në 2 vjetët e fundit në fushën për të cilën kanë aplikuar.

4. Të gjithë përfituesit e sponsorizimit, sipas paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni, duhet të jenë të regjistruar në institucionet përkatëse të Kosovës, sipas ligjeve në fuqi që rregullojnë përkrahjen dhe mbështetjen e aktiviteteve sportive në Republikën e Kosovës.

Neni 7

Procedura e dorëzimit të kërkesës

1. Përfituesi i sponsorizimit i drejtohet me kërkesë komisionit vlerësues në kuadër të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për shqyrtimin e kërkesës për lëshimin e vërtetimit të sponsorizimit pasi të jenë siguruar paraprakisht aprovimet në rastet si në vijim:

1.1. Organizatat sportive ombrellë aplikojnë drejtpërdrejt në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit;

1.2. Federata përkatëse siguron konfirmimin e anëtarësisë në Komitetin Olimpik të Kosovës apo Komitetin Paralimpik të Kosovës;

1.3. Klubi sportiv siguron konfirmimin e anëtarësisë nga federata përkatëse;

1.4. Për sportistin individual aplikon klubi përkatës, i cili duhet të sigurojë konfirmimin e anëtarësisë së klubit dhe sportistit në federatën përkatëse;

1.5. Të gjitha federatat dhe klubet sportive duhet të jenë të licencuara nga Ministria përkatëse për Sport;

1.6. Përfituesit e sponsorizimit në fushën e kulturës dhe rinisë, pasi t'i plotësojnë kriteret e specifikuar në nenet 4 dhe 5 të kësaj rregulloreje, kërkesat e tyre i dorëzojnë në MKRS;

1.7. Personi fizik (individ) në fushën e kulturës, rinisë përfiton përmes organizatës/shoqatës, anëtar i së cilës është, që të mbështesë aplikimin e tij;

1.8 Kërkesa për sponsorizim duhet të përmbajë dokumentacionin si në vijim:

1.9. Marrëveshjen ndërmjet dhënësit dhe pranuesit të sponsorizimit si në nenin 4 (paragrafi 2) të Ligjit për Sponsorizime, e cila duhet të përmbajë:

1.9.1. detyrimet e sponsorizuesit;

1.9.2. qëllimin e sponsorizimit;

1.9.3. përshkrimin e projektit i cili do të sponsorizohet duke përfshirë të gjitha aktivitetet të cilat mbulohen;

1.9.4. kompensimin;

1.9.5. ekskluzivitetin;

1.9.6. mirëbesimin;

1.9.7. shkëputjen;

1.9.8. përjashtimin e përgjegjesisë;

1.9.9. dënimin kontraktor;

1.9.10. hyrjen në fuqi dhe kohëzgjatjen;

1.9.11. ligjet e aplikueshme dhe gjykatën kompetente.

1.10. Marrëveshja ndërmjet dhënësit dhe pranuesit të sponsorizimit duhet të jetë origjinale, e noterizuar dhe t'i respektojë të drejtat kontraktuale sipas ligjeve në fuqi të Republikës së Kosovës;

1.11. Aprovimin përkatës nga organizatat përkatëse sipas përshkrimit në paragrafin 1 të këtij neni;

1.12. Përshkrimin e detajuar të projektit për të cilin kërkohet sponsorizimi duke sqaruar interesin publik, realizimin e qëllimit të sponsorizimit si dhe të dhëna të tjera të sakta për sasinë, vlerën dhe specifika të tjera të projektit (në linjë me formën e aplikimit që duhet plotësuar për vërtetim të sponsorizimit);

1.13. Të dhënat personale për dhënësin dhe përfituesin e sponsorizimit si dhe dokumentacionin tjetër përcjellës që paraqitet përmes aplikacionit.

1.14. Kërkesat nga palët duhet të dorëzohen në zyrën e arkivit të MKRS-së, e cila obligohet që pas protokollimit të tyre t'i përcjellë ato te sekretari i komisionit;

1.15. Afati i fundit për aplikim është dita e premte e javës së parë të muajit dhjetor të vitit aktual;

1.16. Kërkesat do të shqyrtohen nga komisioni në afat brenda pesëmbëdhjetë ditësh duke filluar nga data e dorëzimit të kërkesës.

Neni 8

Komisioni për shqyrtimin e kërkesave

1. Për shqyrtimin e kërkesave Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit formon komision vlerësues prej pesë (5) anëtarësh, për të shqyrtuar, vlerësuar dhe vërtetuar përfundimisht kërkesat për vërtetimin e sponsorizimit në interes publik sipas fushave përkatëse.

2. Komisionin e emëron ministri, me mandat dy (2) vjeçar me mundësi të riemërimit.

3. Komisioni në punën e tij ka të gjitha përgjegjësitë që të shqyrtojë vërtetësinë e dokumenteve zyrtare, të sigurojë zbatimin e plotë të ligjit dhe të akteve të përgjithshme normative në fuqi, të vlerësojë qartësisht dhe në bazë të kriterëve ekzistimin ose jo të interesit publik në çdo kërkesë të sponsorizimit.

4. Komisioni, në afatin e caktuar, mund të kërkojë sqarime shtesë nga aplikuesit për secilën kërkesë të paraqitur, në bazë të kompetencave të veta.

5. Komisioni duhet të përbëhet nga zyrtarë profesionalë si në vijim:

5.1. Një zyrtar ligjor;

5.2. Një zyrtar i financave;

5.3. Një zyrtar i kulturës;

5.4. Një zyrtar i rinisë;

5.5. Një zyrtar i sportit.

6. Anëtarë të rregullt të komisionit janë zyrtari ligjor dhe zyrtari i financave dhe njëri prej tyre zgjidhet kryesues i komisionit.

7. Zyrtarët e kulturës, rinisë dhe sportit marrin pjesë në mbledhjen e komisionit vetëm në shqyrtimin e kërkesave që bien në fushëveprimin e tyre.

8. Puna e komisionit do të ndihmohet nga një nëpunës i MKRS-së, i cili do të shërbejë në cilësinë e sekretarit të komisionit.

Neni 9
Sekretari i komisionit

1. Sekretari i komisionit do të mbështesë dhe do të kujdeset për funksionimin administrativ të komisionit.
2. Ministri emëron një nëpunës të MKRS-së për sekretar të komisionit.
3. Sekretari i komisionit ka këto detyra dhe përgjegjësi:
 - 3.1. Pranon kërkesat për vlerësim;
 - 3.2. Mban regjistrin e përditësuar në çdo kohë;
 - 3.3. Njofton palët;
 - 3.4 Ndhomon në përgatitjen e raporteve dhe mirëmban të gjithë regjistrat zyrtarë të punës në bashkëpunim me kryetarin e komisionit.

Neni 10
Kompensimi për punën e komisionit

1. Anëtarët dhe sekretari i komisionit për punën e tyre kompensohen financiarisht, duke marrë parasysh se emërimi dhe shërbimi në komision është në kapacitet personal dhe nuk derivon nga mandati i një njësie të vetme organizative.
2. Anëtarët e komisionit dhe sekretari do të kompensohen për punën e tyre vetëm atëherë kur marrin pjesë në trajtimin e lëndëve nga fushat përkatëse për të cilat janë emëruar.
3. Mënyra e kompensimit përcaktohet me vendim nga ministri duke u bazuar në legjislacionin përkatës në fuqi.

Neni 11
E drejta e ankesës

Pala e pakënaqur me vendimin e komisionit mund të parashtrojë ankesë në komisionin e ankesave në afat prej 30 ditësh.

Neni 12

Komisioni i ankesave

1. Për shqyrtimin e ankesave të palëve ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit do të formojë një komision në përbërje prej 5 anëtarësh me mandat dy (2) vjeçar me mundësi të riemërimit;
2. Komisioni duhet të përbëhet nga zyrtarë profesionalë si në vijim:
 - 2.1. Një zyrtar ligjor;
 - 2.2. Një zyrtar i financave;
 - 2.3. Një zyrtar i kulturës;
 - 2.4. Një zyrtar i rinisë;
 - 2.5. Një zyrtar i sportit.
3. Anëtarë të rregullt të komisionit janë zyrtari ligjor dhe zyrtari i financave dhe njëri prej tyre zgjidhet kryesues i komisionit.
4. Zyrtarët e kulturës, rinisë dhe sportit marrin pjesë në mbledhjen e komisionit vetëm në shqyrtimin e ankesave që bien në fushëveprimin e tyre.
5. Komisioni vendos për aprovimin e ankesave dhe lëshon vërtetimin e sponsorizimit, nëse refuzon ankesën, atëherë nxjerr vendim për refuzim.
6. Shqyrtimi i ankesave bëhet brenda 15 ditëve dhe është shkallë përfundimtare në procedurë administrative.
7. Anëtarët e komisionit të ankesave do të kompensohen për punën e tyre vetëm atëherë kur marrin pjesë në trajtimin e ankesave nga fushëveprimi përkatës për të cilin janë emëruar.
8. Pala e pakënaqur me vendimin e komisionit të ankesave ka të drejtë të iniciojë procedurën konfliktit administrativ në gjykatën kompetente.

Neni 13

Forma e vërtetimit të sponsorizimit

1. Vërtetimi për përcaktimin e interesit publik për qëllim të realizimit të të drejtave të palëve për sponsorizim, i cili do të procedohet në ATK nga palët përfituese, duhet të përmbajë shënimet si në vijim:
 - 1.1. Të dhënat e sponsorizuesit:

- 1.1.1. Emrin dhe adresën;
 - 1.1.2. Numrin e regjistrimit;
 - 1.1.3. Numrin fiskal;
 - 1.1.4. Xhironlogarinë bankare.
- 1.2. Të dhënat e përfituesit:
- 1.2.1. Emrin dhe adresën;
 - 1.2.2. Numrin e regjistrimit;
 - 1.2.3. Numrin fiskal;
 - 1.2.4. Llogarinë bankare.
- 1.3. Përshkrimin e qëllimit të sponsorizimit duke përfshirë aktivitetet të cilat mbulohen përmes sponsorizimit;
- 1.4. Shumën e sponsorizimit të paraparë me kontratën e nënshkruar dhe të noterizuar;
- 1.5. Kohëzgjatjen e realizimit sipas kontratës së noterizuar;
- 1.6. Nënshkrimet e anëtarëve të komisionit vlerësues apo të komisionit të ankesave në kuadër të MKRS-së;
- 1.7. Vulën zyrtare të Ministrisë për Kulturë, Rini dhe Sport.

Neni 14

Procedura e raportimit vjetor për sponsorizimin e realizuar

1. Përfituesi i sponsorizimit obligohet që të hartojë raport me shkrim lidhur me sponsorizimin e realizuar dhe atë ta dërgojë në komisionin e mbylljes së raporteve në Ministrinë për Kulturë, Rini dhe Sport më së largu 45 ditë nga data e përfundimit të afatit të përcaktuar në vërtetim.
2. Raporti për mbylljen e sponsorizimit për MKRS-në duhet të përmbajë:
 - 2.1. Transaksionin e pranimin të mjeteve brenda vitit kalendarik pas lëshimit të vërtetimit;
 - 2.2. Raportin narrativ, në të cilin përshkruhen të gjitha aktivitetet e realizuara sipas marrëveshjes përkatëse për sponsorizim, si dhe rezultatet e arritura në fushën e caktuar nga marrëveshja, duke i dëshmuar me fotografi apo formë tjetër elektronike;

2.3. Raportin financiar, i cili duhet të përmbajë informatat e detajuara, si: faturat, kontratat, transaksionet bankare, të specifikuara për secilin vërtetim;

2.4. Të gjithë përfituesit e sponsorizimit në vlerë mbi 10 mijë euro brenda vitit janë të obliguar të sjellin raportin e auditimit, nga auditorët e certifikuar.

3. Raportet për mbyllje nga palët duhet të dorëzohen në zyrën e protokollit të MKRS-së, e cila obligohet që pas protokollimit të tyre t'i përcjellë ato te sekretari i komisionit për mbylljen e vërtetimeve.

4. Përfituesit e sponsorizimit:

4.1. Përfituesit e sponsorizimit të cilët nuk raportojnë për mbylljen e sponsorizimeve të cilat i kanë përfituar, atëherë ata nuk mund të jenë përfitues të vërtetimeve të reja të sponsorizimit.

4.2. Përfituesit e sponsorizimit të cilët nuk bëjnë mbylljen e raporteve të sponsorizimit sipas këtij neni do të ndëshkohen sipas nenit 17 të Ligjit Nr. 06/L-116 dhe njëkohësisht ndaj tyre do të kërkohet kthimi i mjeteve përmes organeve të drejtësisë.

Neni 15

Komisioni për mbylljen e raporteve të sponsorizimit

1. Për mbylljen e raporteve të vërtetimeve në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit formohet një komision prej pesë (5) anëtarësh, për të shqyrtuar raportet për mbylljen e vërtetimeve të sponsorizimit sipas fushave përkatëse:

1.1. Komisionin e emëron ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, me mandat dy (2) vjeçar me mundësi të riemërimit;

1.2. Komisioni në punën e tij do të ketë të gjitha përgjegjësitë që të shqyrtojë dokumentacionin për mbyllje sipas nenit 14 të kësaj rregulloreje;

1.3. Komisioni në afatin e caktuar mund të kërkojë sqarime shtesë nga raportuesi për secilën raportim të paraqitur për mbyllje, në bazë të kompetencave të veta;

1.4. Komisioni duhet të përbëhet nga zyrtarë profesionalë si në vijim:

1.4.1. Një zyrtar ligjor;

1.4.2. Një zyrtar i financave;

1.4.3. Një zyrtar i kulturës;

1.4.4. Një zyrtar i rinisë;

1.4.5. Një zyrtar i sportit.

1.5. Anëtarë të rregullt të komisionit janë zyrtari ligjor dhe zyrtari i financave dhe njëri prej tyre zgjidhet kryesues i komisionit;

1.6. Zyrtarët e kulturës, rinisë dhe sportit marrin pjesë në mbledhjen e komisionit vetëm në shqyrtimin e raporteve që bien në fushëveprimin e tyre;

1.7. Puna e komisionit do të ndihmohet nga një nëpunës i MKRS-së, i cili do të shërbejë në cilësinë e sekretarit të komisionit, i cili do të emërohet nga ministri;

1.8. Anëtarët e komisionit dhe sekretari do të kompensohen për punën e tyre vetëm atëherë kur marrin pjesë në trajtimin e lëndëve për mbyllje nga fushat përkatëse për të cilat janë emëruar;

1.9. Mënyra e kompensimit të tyre do të përcaktohet me vendim sipas legjislacionit përkatës.

Neni 16

Letërkonfirmimi për mbyllje

1. Konfirmimi për mbyllje në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit përmban emrin e dhënësit dhe të marrësit të sponsorizimit, numrin e vërtetimit dhe shumën e sponsorizimit.
2. Konfirmimi nënshkruhet nga anëtarët e komisionit për mbyllje, varësisht nga fusha prej së cilës ka ardhur raporti për mbyllje, sporti, kultura apo rinia.
3. Konfirmimi i dërgohet përmes emailit zyrtarit të komisionit, raportuesit si dhe komisionit për lëshimin e vërtetimeve.

Neni 17

Bashkëpunimi ndërmjet komisioneve

1. Të gjitha komisionet janë të obliguara të kenë bashkëpunim dhe t'i bashkërendojnë punët që ndërliken me fushën e sponsorizimit duke i shkëmbyer të dhënat e nevojshme.
2. Komisionet janë të obliguara të mirëmbajnë të dhënat për vërtetimet e lëshuara të sponsorizimit dhe konfirmimeve për mbyllje të sponsorizimeve brenda një regjistri të njëjtë.

Neni 18

Bashkëpunimi ndërinstitucional

1. Të gjitha komisionet të cilat janë përgjegjëse për zhvillimin e procedurave të parapara në këtë rregullore, obligohen që të kenë koordinim të vazhdueshëm me zyrtarët përgjegjës në kuadër të Administratës Tatimore të Kosovës.

2.Koordinimi ndërinstitutional ndërmjet MKRS-së dhe ATK-së bëhet nëpërmjet ndarjes së regjistrit të përditësuar të vërtetimeve të lëshuara dhe raporteve për mbylljen e sponsorizimit.

3.Në rastet kur MKRS identifikon keqpërdorimin e mjeteve nga përfituesit e sponsorizimit apo nga kompanitë sponsorizuese, obligohet që rastin ta informoj në ATK.

Nenin 19 Shtojcat

1. Shtojca të kësaj rregulloreje do të jenë:

- 1.1. Forma e aplikimit për sponsorizimin;
- 1.2. Forma e Marrveshjes;
- 1.3. Udhëzuesi me dokumentacionin e nevojshëm për aplikim;
- 1.4. Forma e raportimit narrativ dhe financiar për mbyllje.

Neni 20 Dispozita shfuqizuese

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohet Rregullorja MKRS Nr. 01/2018 për Përcaktimin e Kriteve, Procedurave dhe Formave për Vërtetimin e Sponsorizimit në Fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Neni 21 Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Hajrulla ÇEKU

Ministër i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Datë: 28.05.2024

Prishtinë, __/__/2024

PËR: MKRS / Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e Kërkesave për lëshimin e Vërtetimit për Sponsorizime në Fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

LËNDA: Kërkesë për vërtetim

Në pajtim me rregulloren (MKRS) për përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe formës për vërtetimin e sponsorizimit në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, dhe pas plotësimit të kriterëve dhe dokumentacionit të kërkuar sipas rregullores dhe Ligjit Nr.05/L-090 për Sponsorizime në Fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, kërkojë nga Komisioni që të më pajis me vërtetim në pajtim me nenin 13 të rregullores MKRS.

Përfitues i Sponsorizimit:

NRB: _____

NRF: _____

ADRESA: _____

TELEFONI: _____

E-MAIL: _____

Dhënës i sponsorizimit:

NRB: _____

NRF: _____

ADRESA: _____

TELEFONI: _____

E-MAIL: _____

Vlera e paraparë për sponsorizim sipas kontratës është: _____

Kontrata është e noterizuar me datë: _____ dhe mban numrin rendor nr. _____.

Përshkruaj me fjalë qëllimin e sponsorizimit dhe arsyet se pse mendon se sponsorizimi në fjalë përbën interes të përgjithshëm publik.

Përshkruaj me fjalë aktivitetet të cilat do të mbulohen me mjetet e sponsorizimit.

Parashtruesi i kërkesës:

Emri & Mbiemri, nënshkrimi

v.v

Në bazë të diskutimeve të mëparshme dhe ujdisë në shprehje të vullnetit të tyre të lirë, e në pajtim me Ligjin për Sponsorizime në Fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Rregulloren për Përcaktimin e Kriteve, Procedurave dhe Formës për Vërtetimin e Sponsorizimit në Fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit Palët e kësaj Marrëveshjeje të Sponsorizimit janë marrë vesh që të lidhin këtë:

MARRËVESHJE PËR SPONSORIZIM NË FUSHËN E (..... shkruaje fushën)

Neni 1

Palët e marrëveshjes së sponsorizimit

Kjo Marrëveshje është lidhur më datën __/__/2024, në Prishtinë, në formë të shkruar, mes palëve në vijim:

(Emri i përfituesit), me seli në Kosovë, Adresa:(*adresa e vendndodhjes*), e regjistruar pranë Ministrisë së Administratës Publike me numër..... (*numri i regjistrimit*), e përfaqësuar nga (*emri i personit përgjegjës*), sipas autorizimit me numër të letërnjoftimit(*numri personal i personit përgjegjës*) në njëren anë (në tekstin e mëtejme Përfituesi i Sponsorizimit); dhe

(Emri i dhuruesit të sponsorizimit), me seli në Kosovë, Adresa:(*adresa e vendndodhjes*), e regjistruar pranë Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës me numër unik identifikues.....(*numri i regjistrimit*), e përfaqësuar nga (*emri i personit përgjegjës*), sipas autorizimit me numër të letërnjoftimit(*numri personal i personit përgjegjës*) (në tekstin e mëtejme Dhuruesi i Sponsorizimit).

Neni 2

Objekti i marrëveshjes

Objekt i kësaj Marrëveshjeje të Sponsorizimit (në tekstin e mëtejme Marrëveshja) është____(*përshkruaj qëllimin kryesor të kësaj marrëveshjeje*) sponsorizimi i veprimtarisë (*përcakto fushën*) të Përfituesit, e cila konsiderohet veprimtari në interes të përgjithshëm, i cili sjell përmirësimin e jetës individuale dhe shoqërore të qytetarëve, organizatave biznesore, fondacioneve, personave fizik dhe juridik në Republikën e Kosovës, në pajtim me Ligjin për Sponsorizime në Fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (Ligji Nr. 05/L-090, në tekstin e mëtejme Ligji për Sponsorizime.

Neni 3

Ujdia mes palëve

Palët në këtë marrëveshje janë marrë vesh se do të veprojnë në mirëbesim dhe do tu përmbahen obligimeve të përcaktuara në nenet 4 dhe 5 të kësaj Marrëveshjeje.

Palët deklarojnë se këtë marrëveshje e kanë lidhur në bazë të vullnetit të tyre të lirë dhe përkitazi me interesat e tyre.

Të dyja palët janë pajtuar që të përpilojnë raporte e sponsorizimit të cilat përmbajnë të dhënat mbi Dhuruesin dhe Përfituesin e sponsorizimit, identifikojnë saktësisht sasinë, vlerën dhe vetitë tjera të sponsorizimit dhe përshkruajnë shfrytëzimin përfundimtar të lëndës së sponsorizimit, si dhe që të njëjtët t'i dorëzojnë pranë Administratës Tatimore të Kosovës (ATK) dhe Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, brenda 30 ditësh pas përmbushjes së kësaj Marrëveshjeje.

Palët deklarojnë se do t'i zgjidhin të gjitha kontestet që mund të rrjedhin në lidhje me zbatimin e kësaj marrëveshjeje me bisedime mes tyre dhe se do t'i shterin të gjitha mjetet para se me ju drejtuar gjykatës kompetente.

Neni 4

Detyrimet e Dhuruesit të Sponsorizimit

Dhuruesi obligohet që në llogarinë bankare të Përfituesit, të paguajë shumën prej€(*shuma e dhuruar*).

Pagesat sipas këtij neni do të bëhen në xhirollogarinë zyrtare të përfituesit brenda vitit kalendarik në:

Emri i përfituesit:

Numri i xhirollogarisë: ...

Banka e përfituesit:.....

- (*renditi obligimet e dhuruesit te sponsorizimit por qe asnjëherë te mos jene ne kundërshtim me ligjet e aplikueshme ne Republikën e Kosovës*)

Neni 5

Detyrimet e Pranuesit të Sponsorizimit

Përfituesi deklaron se mjetet e përfituara përmes kësaj Marrëveshjeje do t'i shfrytëzojë për zhvillim të aktiviteteve që kanë për qëllim avancimin dhe masivizimin e (*përcakto fushën*) te(*emri i sportit qe përfaqëson*), në pajtim me qëllimet e përcaktuara me (*ligjet përkatëse te fushave*), aktet nënligjore që rregullojnë veprimtarinë (*fushave përkatëse*) në Kosovë.

Përfituesi deklaron se të gjitha mjetet të përfituara sipas kësaj marrëveshjeje do t'i shfrytëzojë në mënyrë ligjore dhe transparente dhe për shfrytëzimin e tyre do t'i raportojë Dhuruesit, ATK-së dhe Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për mënyrën dhe modalitetet e shpenzimit të mjeteve në fjalë.

Me këtë shume do te mbulohen shpenzimet operative per mbarëvajtjen e qëndrueshme te aktiviteteve te (*përcakto fushën*), te cilat përfshijnë,

- (*renditja dhe specifikimi i te gjitha aktiviteteve qe do te realizohen me këtë sponsorizim*)

Në kompensim për shumën së Dhuruesi që ia paguan për sponsorizim të veprimtarisë, përfituesit obligohet që gjatë tërë kohëzgjatjes së kësaj Marrëveshjeje t'i sigurojë sponsorit:

- *(renditi obligimet e pranuesit të sponsorizimit por që asnjëherë të mos jene në kundërshtim me ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës)*

Neni 6 **Kohëzgjatja e Marrëveshjes**

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi me datën e nënshkrimit dhe do të mbetet në fuqi deri më ___/___/2024.

Neni 7 **Konfidencialiteti**

Palët pranojnë që gjatë afatit të kësaj Marrëveshjeje dhe më pas kushtet e kësaj Marrëveshjeje janë konfidenciale. Palët dakordohen t'i marrin të gjitha masat që janë të nevojshme që të ruajnë konfidencialitetin e tillë, përveç kur ndryshe kërkohet me këtë Marrëveshjeje. Obligimi i konfidencialitetit do të mbetet me skadimin ose përfundimin e mëhershëm të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 8 **Ndryshimi**

Kjo marrëveshje nuk do të plotësohet, ndryshohet apo modifikohet përveç me shkrim e nënshkruar nga përfaqësuesit e autorizuar me vullnetin e të dyja palëve, dhe e noterizuar te noteri.

Neni 9 **Ligjet e aplikueshme**

Kjo Marrëveshjeje është lidhur në pajtim me Ligjin për Sponsorizime në Fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Në rast se ndonjë nga dispozitat e kësaj Marrëveshjejeje është në kundërshtim me Ligjin për Sponsorizim apo me ligjet tjera të Kosovës, dispozitat ligjore do të mbizotërojnë.

Palët e kësaj Marrëveshjejeje shprehimisht deklarojnë që do t'i përmbahen ligjeve të Kosovës gjatë realizimit të kësaj Marrëveshjejeje dhe obligimeve të tyre që rrjedhin nga e njëjta.

Neni 10
Dënimi kontraktor

Palët për mos përmbushjen e detyrimeve që dalin nga ligji do të sanksionohen sipas Ligjit për Sponsorizime në Fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Neni 11
Zgjedhja e mosmarrëveshjeve dhe gjykata kompetente

Palët obligohen që të gjitha kontestet që mund të rrjedhin nga zbatimi i kësaj marrëveshjeje të përpiqen t'i zgjidhin më mirëbesim dhe pajtim në mes të palëve . Në rast të dështimit në arritjen e zgjidhjes me mirëbesim, palët pajtohen se kompetente për zgjidhjen e kontesteve që rrjedhin nga kjo Marrëveshje do të jetë Gjykata Themelore në..... *(qytetin në të cilin bije kompetenca e gjykatës ne momentin e lidhjes se marrëveshjes).*

Neni 12
Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe vulosjes së saj nga përfaqësuesit zyrtarë të palëve.

(Personi përgjegjës i dhuruesit te sponsorizimit) *(Personi përgjegjës i pranuesit te sponsorizimit)*

(nënshkrimi, vula)

(nënshkrimi, vula)



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

**MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT – MINISTARSTVO
KULTURE, OMLADINE I SPORTA – MINISTRY OF CULTURE, YOUTH AND
SPORT**

Në pajtim me rregulloren për përcaktimin e kritereve, procedurave dhe formës për vërtetimin e sponsorizimit në fushën e Kulturës Rinisë dhe Sportit, do të listojmë listën e dokumentacionit që duhet ti përmbaj lënda për me qen e kompletuar për lëshimin e vërtetimit:

Pranuesi i sponsorizimeve apo dhënësi i sponsorizimit për t'u pajisur me Vërtetim të Sponsorizimit, në pajtim me rregulloren për përcaktimin e kritereve, procedurave dhe formës për vërtetimin e sponsorizimit në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, duhet që përveç kërkesës për sponsorizim të dorëzojë edhe dokumentacionin e shënuar më poshtë:

Dokumentet që duhet t'i bashkëngjiten kërkesës për sponsorizim në fushën e Sportit.

1. Certifikata e Regjistrimit në Autoritetin përkatës (dhënësi dhe marrësi i sponsorizimit);
2. Numri Fiskal (dhënësi dhe marrësi i sponsorizimit);
3. Përfaqësuesi i personit juridik (emri, mbiemri dhe kopja e dokumentit të identifikimit - dhënësi dhe marrësi i sponsorizimit);
4. Numri i llogarisë bankare të dhënësit dhe marrësit të sponsorizimit;
5. Kontrata apo marrëveshja për sponsorizim (sipas specifikave të parapara me rregullore për përcaktimin e kritereve, procedurave dhe formës për vërtetimin e sponsorizimit në fushën e Kulturës Rinisë dhe Sportit);
6. Aprovimin nga Klubi dhe Federata që sportisti mund të pranojë sponsorizimin (vetëm për sportistët individual);
7. Aprovimin nga federata përkatëse (vlen vetëm për klubet);
8. Konfirmimin e anëtarësisë nga KOK (vetëm për Federatat);
9. Licencën e lëshuar nga MKRS (vetëm për Federatat) dhe
10. Kërkesa për lëshim të Vërtetimit (me sqarimin e nevojshme të parapara në rregullore).

Dokumentet që duhet t'i bashkëngjiten kërkesës për sponsorizim në fushën e Kulturës

1. Certifikata e Regjistrimit në Autoritetin përkatës (dhënësi dhe marrësi i sponsorizimit);
2. Numri Fiskal (dhënësi dhe marrësi i sponsorizimit);
3. Përfaqësuesi i personit juridik (emri, mbiemri dhe kopja e dokumentit të identifikimit - dhënësi dhe marrësi i sponsorizimit);
4. Numri i llogarisë bankare të dhënësit dhe marrësit të sponsorizimit;
5. Kontrata apo marrëveshja për sponsorizim (sipas specifikave të parapara me rregullore për përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe formës për vërtetimin e sponsorizimit në fushën e Kulturës Rinisë dhe Sportit);
6. Dëshmia nga organizata jofitimprurëse apo biznesi se aktiviteti i tij/saj zhvillohet në kuadër të organizatës/Biznesit (vetëm për artistët e pavarur), dhe
7. Kërkesa për lëshim të Vërtetimit (me sqarimin e nevojshme te parapara ne rregullore).

Dokumentet që duhet t'i bashkëngjiten kërkesës për sponsorizim në fushën e Rinisë

1. Certifikata e Regjistrimit në Autoritetin përkatës (dhënësi dhe marrësi i sponsorizimit);
2. Numri Fiskal (dhënësi dhe marrësi i sponsorizimit);
3. Përfaqësuesi i personit juridik (emri, mbiemri dhe kopja e dokumentit të identifikimit - dhënësi dhe marrësi i sponsorizimit);
4. Numri i llogarisë bankare të dhënësit dhe marrësit të sponsorizimit;
5. Kontrata apo marrëveshja për sponsorizim (sipas specifikave të parapara me rregullore për përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe formës për vërtetimin e sponsorizimit në fushën e Kulturës Rinisë dhe Sportit);
6. Pëlqimi nga drejtoria komunale (vlen vetëm për Qendrat Rinore të cilat janë të licencuara nga komunat);
7. Aprovimi nga OJQ-ja rinore anëtar i së cilës është (vetëm për individët – personat fizik);
8. Aprovimi nga OJQ-ja rinore që mbështet aplikimin e grupit (vetëm për grupet joformale);
9. Aprovimi nga DKRS-ja (vlen vetëm për Qendrat Rinore) dhe
10. Kërkesa për lëshim të Vërtetimit (me sqarimin e nevojshme te parapara ne rregullore).

RAPORTI NARRATIV

Vërtetimi nr. _____ ; Data: _____

Sponsorizuesi: _____

Shuma e sponsorizuar: _____

Përfituesi i Sponsorizimit: _____

Adresa: _____

Telefoni: _____

E-Mail: _____

Aktivitetet e realizuara.

Rezultatet e arritura

Dëshmi me fotografi apo formë tjetër elektronike te aktiviteve

Raportin narrativ, duhet te permbaj të gjitha aktivitetet e realizuara sipas marrëveshjes përkatëse për sponsorizim, si dhe rezultatet e arritura në fushën e caktuar nga marrëveshja, duke i dëshmuar me fotografi apo formë tjetër elektronike

Përfituesi i sponsorizimit:

(Nënshkrimi dhe vula)

RAPORT FINANCIAR I SHPENZIMEVE

Vërtetimi nr. _____ ; Data: _____

Sponsorizuesi: _____

Shuma e sponsorizuar: _____

Përfituesi i Sponsorizimit: _____

NR.	Përshkrimi i shpenzimit (Faturat, kontratat, transaksionet bankare të specifikuara për secilin vërtetim)	Furnitori	Nr. i faturës/kontratës	Data e faturës	Shuma e shpenzuar
	TOTALI				

Raporti financiar duhet të përmbajë informatat e detajuara: faturat, kontratat, transaksionet bankare, të specifikuara për secilin vërtetim.

Përfituesi i sponsorizimit:

(Nënshkrimi dhe vula)